

VENDIM
Nr.660, datë 12.9.2007

**PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËSVE DHE
KANALIZIMEVE NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 1.II, shkronja “a”, 10, pika 3.I, shkronjat “a” e “b”, dhe 72, pika 5.I, shkronjat “a” e “b” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të neneve 3, shkronja “e”, 4, 6, shkronja “a”, 7, 8 e 16, pika 1 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e aksioneve të shoqërive shtetërore të ujësjellësve dhe kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kur shoqëria e ujësjellësve dhe kanalizimeve mbulon më shumë se një njësi qeverisjeje vendore, bazuar në shitjen me pakicë, në marrëdhëniet tregtare me përdoruesit finalë, aksionet e shoqërisë, që transferohen, u kalojnë njësive të qeverisjes vendore përkatëse në bashkëpronësi, ku pjesa takuese e aksioneve të çdo njësie është në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë së asaj njësie, që mbulohet nga shoqëria e ujësjellësit dhe kanalizimeve.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve sipas këtij vendimi, janë të detyruara, që, për një periudhë kohore prej jo më pak se dy (2) vjetësh nga data e bërjes efektive të transferimit të aksioneve.

a) të mos shesin aksionet e tyre te persona, fizikë ose juridikë, të tjerë, shtetërorë a privatë;

b) të mos kryejnë ndarje të shoqërisë, por ta mbajnë atë si një njësi ligjore të vetme operuese.

4. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përfitojnë prona sipas këtij vendimi, të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me ligjin nr.8744, datë 22.2.2001, të cilin e paraqet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

5. Detyrimet e prapambetura të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, deri në çastin e transferimit, sipas përcaktimeve të bëra në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të shlyhen nga Buxheti i Shtetit dhe bilancet e shoqërive, aksionet e të cilave transferohen, të zhvishen nga detyrimet e prapambetura përpara se të kryhet transferimi i aksioneve të tyre në njësitë e qeverisjes vendore.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme të dokumenteve ligjore dhe të udhëzuesve bazë, të nevojshëm (statuti i shoqërisë së transferuar dhe vendimit nr.642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave “Për këshillat mbikëqyrëse të shoqërive anonime shtetërore”), të cilët do të bëjnë të mundur rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpronësisë, ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, si bashkëpronarë dhe të marrëdhënieve, ndërmjet këtyre të fundit me shoqëritë, që menaxhojnë sistemet e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të transferuara.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të programojë dhe të ndjekë zbatimin e udhëzimeve dhe të akteve nënligjore, për ngritjen e asambleve të ortakëve të njësive të qeverisjes vendore, bashkëpronarë të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, të transferuara sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Pika 3, e lidhjes 2, dhe pikat 1,3,4, sistemet 12 e 13, 5,6 e 7 të lidhjes 3 të vendimit nr.81, datë 12.2.2004 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”, pika 2 e lidhjes 3 të vendimit nr.173, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”, pikat 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9,10,11 e 12 të lidhjes 2 dhe pikat 1, 2, 3, 4, 5, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 e 21 të lidhjes 3 të vendimit nr.809, datë 26.11.2004 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”, si dhe vendimi nr.711, datë 18.10.2006, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”, shfuqizohen.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA 1

Lista e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, aksionet e të cilave do të transferohen në njësitë e qeverisjes vendore (Nj.Q.V)

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarit		Nr. Pasurisë	Njësitë e qeverisjes Vendore		
			Lista nr.____	VKM Nr.____, Date _____		Emri i Njesisë	Nr. Popullatës	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
1	Ujësjellës Kraste	Sh.a		366,05.06.2003	2,735	Komunës Martanesh	2,735	100,0
2	Ujësjellës Selenice	Sh.a			7,012	Bashkisë Selenice	7,012	100,0
3	Ujësjellës Rubik	Sh.a	7	643,18.09.2003	8,059	Bashkisë Rubik	8,059	100,0
4	Ujësjellës Bilisht	Sh.a	7	366,05.06.2003	9,704	Bashkisë Bilisht	9,704	100,0
5	Ujësjellës Orikum	Sh.a			11,036	Bashkisë Orikum	11,036	100,0
6	Ujësjellës Poliçan	Sh.a	10	251,24.04.2003	12.164	Bashkisë Poliçan	9,530	78,3
						Komunës Bogovë	2,534	20,8
						Komunës Vendreshë	100	0,8
7	Ujësjellës Përmet	Sh.a	9	251,24.04.2003	13.830	Bashkisë Përmet	10,742	77,7
						Komunës Petran	3,088	22,3
8	Ujësjellës Has	Sh.a	20	366,05.06.2003	13.453	Bashkisë Krumë	7,705	57,3
						Komunës Fajza	4,201	31,2
						Komunës Gjinaj	1,547	11,5
9	Ujësjellës Kanalizime Peqin	Sh.a			14.138	Bashkisë Peqin	8,919	63,1
						Komunës Shezë	5,219	36,9

10	Ujësjiellës kanalizime Mirdite	Sh.a			17.953	Bashkisë Rrëshen	14.253	79.4
						Komunës Selitë (pjesërisht)	2.500	13.9
						Komunës Orosh (pjesërisht)	1.200	6.7
11	Ujësjiellës Bulqizë	Sh.a	1	251,24.04.2003	18.305	Bashkisë Bulqizë	13.913	76.0
						Komunës Shupenze (pjs)	4.392	24.0
12	Ujësjiellës Kanalizime Librazhd	Sh.a	5	643,18.09.2003	19.187	Bashkisë Librazhd	10.123	52.8
						Bashkisë Përrenjas	8.264	43.1
						Komunes Qendër	600	3.1
						Komunës Rrajcë (pjeseri)	200	1.0
13	Ujësjiellës Kanalizime Krujë	Sh.a	7	643,18.09.2003	19.514	Bashkise Krujë	15.789	80.9
						Komunës Cudhi	3.725	19.1
14	Ujësjiellësi Skrapar	Sh.a	13	251,24.04.2003	23.599	Bashkisë Çorovodë	8.422	35.7
						Komunës Qendër	6.097	25.8
						Komunës Potom	1.310	5.6
						Komunës Çepan	1.515	6.4
						Komunës Gjerbës	1.817	7.7
						Komunës Vendreshë	100	0.4
						Komunës Bogovë	2.534	10.7
						Komunës Zhepë	1.804	7.6
15	Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë	Sh.a	12	251,24.04.2003	21.241	Bashkisë Rrogozhinë	11.123	52.4
						Komunës Gosë	8.124	38.2
						Komunës Sinaballaj	1.994	9.4
16	Ujësjiellës Ura Vajgurore	Sh.a	6	366,05.06.2003	21,985	Bashkisë Ura Vajgurore	12.011	54,6
						Komunës Poshnjë	9.974	45.4
17	Ujësjiellës Mat	Sh.a	1	643,18.09.2003	23.259	Bashkisë Burrel	18.195	78.2
						Komunës Lis	5.064	21,8
18	Ujësjiellës Kanalizime Pukë	Sh.a	11	251,24.04.2003	23.430	Komunës Rrapë	2.652	11,3
						Komunës Qafe Mali	2.067	8.8
						Komunës Gjegjan	4.855	20,7
						Komunës Blerim	2.432	10.4
						Komunës Qelëz	2,639	11,3
						Komunës Fierzë	2.556	10.9
						Komunës Qerret	3.509	15,0
						Komunës Iballë	2.720	11,6
19	Ujësjiellësi Tropojë	Sh.a	2	366,05.06.2003	28.168	Bashkisë Bajram Curri	8.460	30,0
						Komunës Margegaj	3.081	10.9
						Komunës Tropojë	5.669	20.1
						Komunës Bujan	3.608	12.8
						Komunës Llugaj	2.371	8.4
						Komunës Fierzë	2.917	10,4
20	Ujësjiellës Gramsh	Sh.a	3	251.24.04.2003	30.576	Komunës Bytyç	2.062	7,3
						Bashkisë Gramsh	14.542	47.6
						Komunës Kushovë	1.230	4.0
						Komunës Pishaj	7.873	25.7
						Komunës Tunjë	2.228	7.3
						Komunës Sult	1.455	4.8

						Komunës Kodovjal	3.248	10.6
21	Ujësjiellësi Kukës	Sh.a	9	366,05.06.2003	31.770	Bashkisë Kukës	21.308	67.1
						Komunës Shtiçqën	4.033	12.7
						Komunës Bicaj	6.429	20.2
22	Ujësjiellësi Tepelenë	Sh.a	14	643,18.09.2003	34.050	Bashkia Tepelenë	8.208	24.1
						Bashkia Memaliaj	7.399	21.7
						Komunës Qendër Tepelen	6.799	20.0
						Komunës Qendër Memaliaj	3.546	10.4
						Komunës Qesarat	2.665	7.8
						Komunës Krahës	3.910	11.5
						Komunës Kurvelesh	1.523	4.5
23	Ujësjiellësi Gjirokastrë Qytet	Sh.a	18	366,05.06.2003	37.241	Bashkisë Gjirokastrë	35.241	94.6
						Kom. Lunxhëri (pjesërisht)	2.000	5.4
24	Ujësjiellës Kanalizime Mallakastrë	Sh.a	11	643,18.09.2003	38.090	Bashkisë Ballsh	11.698	30.7
						Komunës Qendër Dukas	8.811	23.1
						Komunës Aranitas	4.474	11.7
						Komunës Hekal	4.776	12.5
						Komunës Kute	3.426	9.0
						Komuna Fratar	4.905	12.9
25	Ujësjiellës Kanalizime Lezhë	Sh.a	13	366,05.06.2003	47.565	Bashkisë Lezhë	26.156	55.0
						Komunës Shëngjin	10.864	22.8
						Komunës Balldre	10.545	22.2
26	Ujësjiellësi Kuçovë	Sh.a	5	251,24.04.2003	49.034	Bashkia Kuçovë	30.303	61.8
						Komunës Perondi	8.098	16.5
						Komunës Kozare	10.633	21.7
27	Ujësjiellës Kanalizime Peshkopi	Sh.a	8	251,24.04.2003	50.184	Bashkisë Peshkopi	18.445	36.8
						Komunës Kala e Dodës	3.340	6.7
						Komunës Slllovë	3.435	6.8
						Komunës Fushë Cidhen	4.027	8.0
						Komunës Luzni	3.736	7.4
						Komunës Kastriot	7.698	15.3
						Komunës Qendër Tomin	9.503	18.9
28	Ujësjiellës Kanalizime Malësi e Madhe	Sh.a	6	251.24.04.2003	54.418	Bashkisë Koplik	11.001	20.2
						Komunës Shkrel	5.998	11.0
						Komunës Qendër Koplik	5.881	10.8
						Komunës Kastrat	12.104	22.2
						Komunës Kelmend	6.669	12.3
						Komunës Gruemirë	12.765	23.5
29	Ujësjiellës Kanalizime Pogradec	Sh.a	10	366.05.06.2003	55.755	Bashkisë Pogradec	39.646	71.1
						Komunës Buçimas	16.109	28.9
30	Ujësjiellës Patos	Sh.a	17	366.05.06.2003	59.714	Bashkisë Patos	32.499	54.4
						Komunës Cakran	16.183	27.1
						Komunës Portëz	11.032	18.5
31	Ujësjiellësi Shkodër	Sh.a	4	366.05.06.2003	68,770	Komunës Bërdicë	9.101	13.2

	Fshat					Komunës Velipojë	8.403	12.2
						Komunës Hajmel	6.319	9.2
						Komunës Gur i Zi	11.591	16.9
						Komunës Ana e Malit	5.847	8.5
						Komunës Shalë	5.044	7.3
						Komunës Rrethinat	22.465	32,7
32	Ujësjiellësi Kanalizime Kurbin	Sh.a			64.549	Bashkisë Lac	29.891	46.3
						Bashkisë Mamurras	21.852	33.9
						Komunës Milot	12.806	19,8
33	Ujësjiellës Kanalizime Sarandë	Sh.a	17	643,18.09.2003	61.942	Bashkisë Sarandë	39.192	63.3
						Komunës Dhimër	6.255	10.1
						Komunës Aliq	8.563	13.8
						Komunës Mesopotam	6.132	9.9
						Komunës Finiq (F.Vrion)	1.800	2.9
34	Ujësjiellësi Korçë Fshat	Sh.a	9	643,18.09.2003	86.681	Bashkisë Maliq	8.075	9,3
						Komunës Drenovë	10.920	12,6
						Komunës Voskop	6.150	7.1
						Komunës Qendër Bulgarec	13.644	15.7
						Komunës Pojan	17.145	19.8
						Komunës Progër	6.041	7.0
						Komunës Vreshtas	10.391	12,0
						Komunës Libonik	14.315	16.5
35	Ujësjiellësi Berat	Sh.a	1	366,05.06.2003	84.257	Bashkisë Berat	63.724	75.6
						Komunës Vërtop	7.211	8.6
						Komunës Otlak	13.322	15.8
36	Ujësjiellës Kanalizime Korçë	Sh.a	19	366.05.06.2003	86.040	Bashkisë Korçë	86.040	100.0
37	Ujësjiellës Kanalizime Kavajë	Sh.a	12	643,18.09.2003	91.848	Bashkisë Kavajë	38.291	41.7
						Komunës Synej	10.087	11.0
						Komunës Golem	11.241	12.2
						Komunës Helmës	4.548	5.0
						Komunës Lekaj	9.367	10.2
						Komunës Luz i Vogël	9.740	10.6
						Komunës Kryevdh	8.574	9.3
38	Ujësjiellësi Lushnjë Fshat	Sh.a	12	366,05.06.2003	102.925	Komunës Tërbuf	14.830	14.4
						Komunës Kolonjë	8.145	7.9
						Komunës Libofsh/Fier	10.303	10.0
						Komunës Dushk	10.928	10.6
						Komunës Fier Shegan	8.843	8.6
						Komunës Allkaj	5.978	5.8
						Komunës Bubullime	6.974	6.8
						Komunës Krutje	10.029	9,7
						Komunës Poshnje/Berat	9.974	9.7
						Komunës Gradisht	10.501	10.2
						Komunës Remas	6.420	6.2

39	Ujësjiellësi Kanalizime Shkodër	Sh.a	14	251.24.04.2003	112.783	Bashkisë Shkoder	112.783	100.0
40	Ujësjiellësi Elbasan Fshat	Sh.a	5	366,05.06.2003	141.544	Bashkisë Cerrik	14.620	10,3
						Bashkisë Belsh	13.955	9,9
						Komunës Grekan	4.901	3,5
						Komunës Gostimë	12.118	8,6
						Komunës Shalës	6.951	4,9
						Komunës Kajan	6.268	4,4
						Komunës Rrasë	2.235	1,6
						Komunës Fierzë	3.742	2,6
						Komunës Papër	8.916	6,3
						Komunës Gjergjan	7.519	5,3
						Komunës Mollas	7.376	5,2
						Komunës Bradashesh	12.539	8,9
						Komunës Gracen	2.527	1,8
						Komunës Gjinar	4.809	3,4
						Komunës Zavalinë	2.104	1,5
						Komunës Labinot Fushë	6.010	4,2
41	Ujësjiellës Elbasan Qytet	Sh.p. k			131.643	Komunës Lahinot- Mal	5.450	3,9
						Komunës Shushicë	10.177	7,2
						Bashkisë Elbasan	124.643	94,7
						Komunës Bradashesh (pjes	7.000	5,3

42	Ujësjiellës Vlorë	Sh. a	16	251,24.04.2003	182.296	Bashkisë Vlorë	128.744	70,6
						Bashkisë Himarë	11.613	6,4
						Komunës Shushicë	9.114	5,0
						Komunës Armen	7.772	4,3
						Komunës Kote	7.343	4,0
						Komunës Qendër	17.710	9,7
43	Ujësjiellës Kanalizime Fier	Sh.a	13	643,18.09.2003	158.648	Bashkisë Fier	84.125	53,0
						Bashkisë Roskovec	8.491	5,4
						Komunës Topojë, Seman	7.375	4,6
						Komunës Dermenas	12.070	7,6
						Komunës Levan	16.709	10,5
						Komunës Frakull	10.040	6,3
						Komunës Qendër	11.801	7,4
44	Ujësjiellës Gjirokastër fshat	Nderm.			41.885	Komunës Kuman	8.037	5,1
						Komunës Lunxheri	5.216	12,5
						Komunës Qender Libohov	2.930	7,0
						Komunës Lazarat	3.364	8,0
						Komunës Cepo	4.538	10,8
						Komunës Antigone	1.807	4,3
						Komunës Odrie	1.608	3,8
						Komunës Picar	2.118	5,1
						Komunës Zagori	1.316	3,1

						Komunës Dropull i Sipërm	9.590	22.9
						Komunës Dropull i Poshtë	9.398	22.4

45	Ujësjiellësi Kanalizime Tiranë	Sh.a	15	366,05.06.2003 643,18.09.2003	836.064	Bashkisë Tiranë	606.437	72,5
						Bashkisë Kamëz	85.123	10.2
						Bashkisë Vorë	11.500	1.4
						Komunës Bërzhitë	5.639	0,7
						Komunës Shëngjergj	3.475	0,4
						Komunës Prezë	3.500	0,4
						Komunës Petrelë	6.389	0.8
						Komunës Dajt	10.589	1,3
						Komunës Baldushk	5.424	0,6
						Komunës Paskuqan	36.710	4,4
						Komunës Zall Herr	9.895	1.2
						Komunës Kashar	19.412	2,3
						Komunës Farkë	10.797	1,3
						Komunës Krrabë	3.053	0.4
						Komunës Bërxullë	9.094	1.1
46	Ujësjiellës Kanalizime Delvinë	Sh.a	3	366,05.06.2003	15.444	Komunës Vaqarr	9.027	1.1
						Bashkisë Delvinë	13.944	90.3
47	Ujësjiellësi Kanalizime Durrës	Sh.a	10	643,18.09.2003	358.498	K.Mesopotam (F. Bistrice)	1.500	9.7
						Bashkisë Durrës	196.075	54,7
						Bashkisë Shijak	12.799	3,6
						Bashkisë Vore	7.000	2.0
						Bashkisë Sukth	24.304	6,8
						Bashkisë Manëz	9.031	2.5
						Komunës Thumanë	16.703	4,7
						Komunës Ishëm	3.580	1,0
						Komunës Xhafzotaj	16.123	4,5
						Komunës Rrashbull	25.841	7.2
						Komunës Katund i Ri	15.397	4.3
						Komunës Bubq	7.882	2.2
						Komunës Prerë	2.849	0,8
						Komunës Fush-Kuqe	8.440	2,4
						Komunës Maminas	6.633	1.9
						Komunës Gjepalaj	5.841	1,6

LIDHJA 2

Detyrimet financiare të prapambetura të shoqërive të ujësjiellësve dhe kanalizimeve deri më 31.08.2007.

nr	Emërtimi i ndërmarrjes	Sig. 000/leke	Tatimet 000/leke	ARMO 000/leke	Energji 000/leke	Alpetrol sh.a	Totali i detyrimit
1	sh.a ujesj. kanaliz. Kraste	552.00	31.00	-	171.00		754.00
2	“ “ Selenice		-		2.79700		2.797.00
3	“ “ Rubik	-	-	-			-
4	“ “ Bilisht	-	3,98200		1.43200		5.414.00

5	“	“	Orikum				1.167.00		1.167.00
6	“	“	Poliçan	9.530.00	5.563.00	-	1.668.00		16,761.00
7	“	“	Përmet	1,413.00	-	-	1.824.00		3,237.00
8	“	“	Has	4.293.00	2,521.00	-	1.683.00		8,497.00
9	“	“	Peqin	1.274.00	-	-	1.381.00		2,655.00
10	“	“	Mirdite	3.614.00	2.075.00	-	1.964.00		7,653.00
11	“	“	Bulqizë	7.916.00	4.329.00	-	853.00		13.098.00
12	“	“	Librazhd			-	129.00		129.00
13	“	“	Kruje	1.965.00	9.882.00	-	52.00		11,899.00
14	“	“	Skrapar	-	-	-	1.87700		1,877.00
15	“	“	Rrogozhine	-	-	-	1.345.00		1,345.00
16	“	“	Ura vajguore	-	-	-	1.856.00		1,856.00
17	“	“	Mat	9.093.00	13.328.00	-	-		22,421.00
18	“	“	Puke	4.543.00	103.00	-	44.00		4,690.00
19	“	“	Tropojë	1.499.00	-	-	3.917.00		5,416.00
20	“	“	Gramsh	1.575.00	-		156.00		1,731.00
21	“	“	Kukës	1.394.00	30.267.00	-	-		31,661.00
22	“	“	Tepelene	-	-	-	4.505.00		4,505.00
23	sh.a	ujesj. kanaliz.	Gjirokastrë qytet	9,559.00	-	-	1.500.00		11.059.00
24	“	“	Mallakastër	5.323.00	335.00	122.649.00	1.413.00		129,720.00
25	“	“	Lezhe	-	-	.	12,118.00		12,118.00
26	“	“	Kuçove	74.560.00	1.729.00		5.558.00		81,847.00
27	“	“	Peshkopi	-		-	1.792.00		1,792.00
28	“	“	Malësi e Madhe	7,500.00	-	-	-		7,500.00

29	“	“	Pogradec	-	-	-	-		-
30	“	“	Patos	24.000.00	-	4.000.00	22.796.00	288.000.00	338,796.00
31	“	“	Shkodër fshat	5,326.00	-	-	2.945.00		8,271.00
32	“	“	Kurbin	6,558.00	12.006.00	-	15,457.00		34,021.00
33	“	“	Sarandë	-	-	-	8.802.00		8,802.00
34	“	“	Korçë fshat	7,899.00	4,885.00	-	2.237.00		15,021.00
35	“	“	Berat	27,899.00	53,216.00	-	1.010.00		82,125.00
36	“	“	Korçë qytet	-	-	-	-		.
37	“	“	Kavajë	-	-	-	6.450.00		6,450.00
38	“	“	Lushnjë fshat	18,595.00	-	-	4,361.00		22,956.00
39	“	“	Shkodër qytet	68,217.00	88,324.00		29,840.00		186,381.00
40	“	“	Elbasan fshat	8,285.00	.	.	22.672.00		30,957.00
41	shpk	ujes.kanaliz.	Elbasan qytet	27,935.00	-	.	-		27,935.00
42	sha	ujësjellës	Vlorë	-	-	-	31.349.00		31,349.00
43	sh.a	ujesj. Kanaliz.	Fier	3,049.00	.	-	32.756.00		35,805.00
44	Nd.	ujësjellësit	Gjirokastrë fshat	3,096.00	-	-	1.202.00		4,298.00
45	sh.a	ujesj. kanalizime	Tiranë	68,442.00	-	-	-		68,442.00
46	Delvine			-	-	-	3.098.00	-	3,098.00
47	“	“	Durrës	-	-	-	109.408.00	-	109,408.00
	Shuma			414,904.00	232,576.00	126,649.00	345,585.00	288,000.00	1,407,714.00



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT
FIER

Nr. 186/2 Prot.

Fier me: 08/03/2016



LENDË: Kthim përgjigje për ligjshmerinë e vendimeve të Keshillit Bashkiak Fier

DREJTUAR: Z.Armando Subashi
Kryetar i Bashkisë
Fier

Bazuar në Ligjin nr.8927 datë 25.07.2002 "Për Prefektin" nëni 14 shqyrtuam vendimet e Keshillit të Bashkisë Fier të marra në mbledhjen e datës 26.02.2016.

Vendimi nr.17 datë 26.02.2016- "Për përcaktimin e kriterëve specifikë të trajtimit me ndihmë financiare të menjhershme të familjeve të varfra e personave në nevojë" është në përputhje me ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore dhe në zbatim të ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar.

Vendimi nr.18 datë 26.02.2016 - "Për disa ndryshime të VKB-se nr 49 datë 03.12.2015 për strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore" të vitit 2016" është në përputhje me ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe në zbatim të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për shtimin e taksave dhe tarifave vendore" i ndryshuar.

Vendimi nr.19 datë 26.02.2016 - "Për disa ndryshime në Buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2016", është në përputhje me ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe në zbatim të ligjit nr. 147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016".

Vendimi nr.20 datë 26.02.2016- "Për miratimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për leje punimesh pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Fier" është në përputhje me ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe në zbatim të ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Vendimi nr.21 datë 26.02.2016 - "Për kalimin e Aksioneve në pronësi të ish-komunave në pronësi të Bashkisë Fier" është në përputhje me ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe në zbatim

Vendim nr.22 datë 26.02.2016 - "Për ndryshime në listën e pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohej të transferohen në pronësi të Njësise Administrative Qender, Bashkia Fier është në përputhje

139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" dhe ne zbatim te ligjit nr.8744 date 22.02.2001 "Per transferimin e pronave te paluajteshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore".

Vendimi nr.23 date 26.02.2016 - "Per miratimin e projekteve prioritare te Bashkise Fier" eshte ne perputhje me ligjin 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" dhe ne zbatim te ligjit nr.107/2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.


Vendimi nr.24 date 26.02.2016 - "Per miratimin e strategjise territoriale te Bashkise Fier" eshte ne perputhje me ligjin nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" dhe ne zbatim te ligjit nr.107/2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.

Vendimi nr.25 date 26.02.2016 - "Per nje ndryshim ne VKN-ne nr.40 date 26.10.2015 mbi shpalljen e emergjences mjedisore ne fushen e menaxhimit te mbetjeve urbane" eshte ne perputhje me ligjin nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore".

Vendimi nr.26 date 26.02.2016 - "Per miratimin e listes se nxenesve te klasave te 11,12,13 te shkolles se mesme profesionale Petro Sota dhe Jakov Xoxa eshte ne perputhje me ligjin. Sjellim ne vemendjen tuaj respektimin e kriterëve dhe afteve te VKM-se nr.911 date 11.11.2015 "Per percaktimin e kriterëve per perfitimin e bursave e pagesave dhe per kuotat financiare te ushqimit ne mensa e konvikte, per nxenesit e studentet ne Institucionet Arsimore Publike Per vitin shkollor 2015-2016.

PREFEKTI

Xhevit BUSHI





BASHKIA FIER

Adresa: Lagjia "Kastriot"; Rruga "Ramiz Aranitasi"; Nr.15 Fier - SHQIPËRI Tel. 034 410 636; bashkia fier.gov.al

Nr. 1088/2

VENDIM

107. 26.02. 2016

Nr. 21 date 26.02. 2016.



"Për Kalimin e Aksioneve ne pronesi te ish Komunave ne pronesi te Bashkise Fier"

Në mbështetje të, Ligjit 139 date 17.12.2015 "Per Veteqeverrisjen Vendore; Ligjit 115 date 18.12.2014 "Per Ndarjen Administrativo Territoriale te Njesive te Qeverrisjes vendore ne republiken e Shqiperise"; Ligjit 9901 "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"; VKM Nr 63 date 27.01.2016 "Per riorganizimin e Operatoreve qe Ofrojne Sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura"; VKM Nr 510 date 10.06.2015, "Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupezuara e te patrupezuara, te arkivave dhe cdo dokumentacioni tjeter zyrtar ne njesite e qeverrisjes vendore, te prekura nga riorganizimi territorial", Këshilli i Bashkisë Fier në mbledhjen e tij të datës .../2/2016, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI :

1. Te miratoje ndryshimin e aksionereve te Ujesjelles Kanalizimeve sh.a. nga aksione te ish komunave ne aksione te Bashkise Fier poshte:

- Komuna Portez 18.5% te aksioneve te Ujesjellesit Patos
- Komuna Cakran 27.1% te aksioneve te Ujesjellesit Patos
- • Komuna Topoje 4.6% te aksioneve te Ujesjellesit Fier
- • Komuna Dermenas 7.6 % te aksioneve te Ujesjellesit Fier
- • Komuna Levan 10.5 % te aksioneve te Ujesjellesit Fier
- Komuna Frakull 6.3% te aksioneve te Ujesjellesit Fier
- • Komuna Qender 7.4% te aksioneve te Ujesjellesit Fier
- Komuna Libofshe 10% te aksioneve te Ujesjellesit Lushnje Fshat

2. Te miratoje aksionet e Bashkise Fier me rezultat perfundimtar si me poshte:

- Bashkia Fier 10% te aksioneve te Ujesjelles Lushnje Fshat sh.a.
 - Bashkia Fier 45.6% te aksioneve te Ujesjelles sh.a. Patos
 - Bashkia Fier 89.5 % te aksioneve te Ujesjelles Sh.a. Fier
3. Te miratoje inventarizimin fizik, transferimin dhe rregjistrimin ne kontabilitetin e Ujesjellesave, te aseteve ne pronesi te ish Komunave.
 4. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme Ekonomike e Bashkisë dhe Drejtoria e Pergjithshme e Legjislacionit.
1. Ky vendim u shpall më datë 26.02.2016
 2. Ky vendim hyn në fuqi, sipas Ligjit



KRYTARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Evis SEMA



VENDIM

Nr. 63, datë 27.1.2016

PËR RIORGANIZIMIN E OPERATORËVE QË OFROJNË SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIN, LARGIMIN DHE TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 213 e vijues të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të shkronjave "a" e "b", të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

RIORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

1. Riorganizimin e të gjitha shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, sipas ndarjes së re administrative-territoriale, në përputhje me ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

2. Të gjitha njësitë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura organizohen si shoqëri aksionare, sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Bashkive u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., aktuale, në pronësi të ish-njësive të qeverisjes vendore të shkruara, sipas ndarjes së re administrative-territoriale. Bashkitë ndjekin procedurat e kalimit të aksioneve në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Në ato bashki, ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, bashkia, brenda datës 31 dhjetor 2016, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrativo-territoriale.

5. Bashkitë dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit, si dhe çdo të drejtë /detyrim që rrjedh prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe ish-njësive të qeverisjes vendore me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me shoqëritë kontraktuese.

6. Në rastet kur në dy ose më shumë bashki ekziston vullneti i përbashkët për krijimin e një shoqërie të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., të përbashkët, në bazë të nevojave për këtë bashkim e të studimit përkatës, ato do të mbështeten me investime nga qeverisja qendrore.

7. Në rastet kur një shoqëri e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., ekzistuese, mbulon me shërbim më shumë se një bashki apo në rastin e parashikuar në pikën 6, të këtij vendimi, organet themeluese të shoqërisë përbëhen nga përfaqësuesit e bashkive përkatëse, pesha e vendimmarrjes së të cilëve është në raport të drejtë me përqindjen e aksioneve që disponon secila bashki. Këshillat bashkiakë përkatës bëjnë miratimin e përqindjeve takuese të aksioneve sipas pikës 3, të këtij vendimi, dhe organet e shoqërisë bëjnë regjistrimin e aksioneve sipas legjislacionit në fuqi.

8. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., kanë detyrimin të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve dhe prefektit të qarkut për të gjitha të dhënat dhe informacionet sipas formateve e afateve të përcaktuara prej saj. Formatet e dhënies së informacionit miratohen me udhëzime të ministrit të linjës. Gjithashtu, shoqëritë kanë detyrimin për të raportuar për pjesën e tyre të të dhënave që duhet të hidhen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

9. Ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve, në planifikimin e fondeve për

investime nga buxheti i shtetit dhe institucionet financiare ndërkombëtare udhëhiqet nga dokumentet strategjike sektoriale të miratuara, si dhe nga performanca e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a.

10. Stafi menaxherial dhe operacional i shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., i nënshtrohet procesit të trajnimit dhe certifikimit sipas programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve.

KREU II

DISPOZITA KALIMTARE E TË FUNDIT

1. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., organizohen në përputhje me statutin tip, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha bashkitë dhe shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", bëjnë zgjerimin dhe zvogëlimin e kapitalit, sipas rastit, duke shtuar ose duke hequr kapitalet e sistemeve publike të ujësjellës-kanalizimeve që i bashkohen ose që i hiqen.

3. Të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., brenda 3 (tre) muajve nga riorganizimi, aplikojnë për t'u pajisur me licencë për kategoritë përkatëse të shërbimeve dhe për rishikim të tarifave pranë ERRU-së.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 12.9.2007, "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njërive të qeverisjes vendore", nr. 677, datë 3.10.2007, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 642, datë 11.10.2005, të Këshillit të Ministrave "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore", nr. 678, datë 3.10.2007, "Për një shtesë në vendimin nr. 271, datë 9.5.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore", shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Enti Rregullator i Ujit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, njësitë e qeverisjes vendore, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

LIDHJA NR. 1 STATUTI TIP I SHOQËRIVE AKSIONARE, SHTETËRORE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE"_"

Neni 1

Emërtimi dhe selia

1. Shoqëria aksionare ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkisë/bashkive, aksionarë të saj.

2. Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet Ujësjellës-Kanalizime sh.a., .

3. Selia e shoqërisë është në adresën .

Neni 2

Objekti

1. Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", është:

- a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM

Nr. 510, datë 10.6.2015

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE, PERSONELIT, AKTIVEVE TË TRUPËZUARA DHE TË PATRUPËZUARA, TË ARKIVAVE DHE ÇDO DOKUMENTACIONI TJETËR ZYRTAR NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE, TË PREKURA NGA RIORGANIZIMI ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 70, të ligjit nr. 30/2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial.

KREU I

PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. "Bashki", bashkitë e konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar me ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
2. "Njësi që shkrihet" (NJSH), njësi e qeverisjes vendore, komunë ose bashki, që me ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", është shkrihet.
3. "Grup i punës", grupi i punës që ngrihet, sipas këtij vendimi, pranë çdo bashkie për të siguruar zbatimin e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve.
4. "Pasqyrë financiare individuale", pasqyrat financiare të njësive vendore ekzistuese përpara zgjedhjeve vendore të vitit 2015, që përgatiten në formatin e përcaktuar me udhëzimet nr. 14, datë 28.12.2006, nr. 26, datë 27.12.2007 dhe nr. 29, datë 24.12.2013, të ministrit të Financave.
5. "Pasqyra financiare të konsoliduara", pasqyrat financiare të njësive të shkrihet dhe ato të bashkisë, të paraqitura në një të vetme, sipas të njëjtit format me ato të pasqyrave financiare individuale.

KREU II

GRUPI I PUNËS PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT

1. Kryetari i bashkisë është personi përgjegjës për zbatimin e procedurave dhe detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, ky vendim, si dhe aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të tij.
2. Për zbatimin e procedurave të transferimit ngrihet grupi i punës në çdo bashki. Grupi i punës ngrihet me urdhër të Kryetarit të bashkisë, drejtohet nga nënkryetari i saj dhe ka në përbërje, të paktën, një përgjegjës finance, një jurist, një specialist të arkivit dhe një specialist të burimeve njerëzore.
3. Drejtuesi i grupit të punës raporton, në mënyrë periodike, te Kryetari i bashkisë, për zbatimin e detyrave dhe problematikën në lidhje me transferimin.
4. Drejtuesi i grupit të punës bashkërendon punën dhe bashkëpunon me Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale. Kryetari i bashkisë informon me shkrim, në fund të çdo muaji, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim dhe problematikën e hasur gjatë procesit të transferimit, ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore.
5. Kryetari i NJSH-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi, të këtij vendimi, si dhe akteve nënligjore që do të dalin në zbatim të tij, detyrohet të bashkërendojë punën dhe të bashkëpunojë me Kryetarin e bashkisë, grupin e punës dhe Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale për dorëzimin e detyrës dhe

inventarëve përkatës.

6. Mospërbushja e detyrimit për bashkëpunim dhe informim, në zbatim të këtij vendimi, përbën shkelje administrative.

KREU III

TRANSFERIMI I TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE

1. Bashkia është trashëgimtari ligjor i njësive të qeverisjes vendore që janë shkrië në të. Bashkia, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrië, përfshirë edhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

2. Me qëllim njehsimin e afateve të kontratave të shërbimit të të njëjtit lloj, bashkia, me përfundimin e kontratave të lidhura nga NJSH- të, në procedurat e reja të prokurimit nuk mund të tejkalojë afatet e kontratës ekzistuese më të gjatë. Në përfundim të afatit të kontratës ekzistuese më të gjatë, bashkia duhet të fillojë procedurat e prokurimit dhe të lidhjes së një kontrate të re, brenda juridiksionit territorial të saj.

KREU IV

TRANSFERIMI I PERSONELIT

Marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet NJSH-ve dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj. Nga momenti i konstituimit deri në miratimin e strukturës administrative përfundimtare, bashkia është në proces ristrukturimi dhe operon me strukturë transitore, e cila miratohet nga kryetari i saj, brenda 1 muaji nga marrja e mandatit.

a) Për punonjësit me kontratë, që nuk janë nëpunës civilë, marrëdhënia e punës transferohet automatikisht. Nëse gjatë procesit të ristrukturimit punonjësve u shkurtohet vendi i punës apo, për shkak të kualifikimeve dhe kushteve të punës, nuk mund të përshtaten në strukturën provizore apo strukturën e re të bashkisë, atëherë atyre u ndërpritet marrëdhënia e punës, duke respektuar afatet dhe procedurat e njoftimit, sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

b) Për punonjësit që mbulojnë pozicione të shërbimit civil, për të cilët është lëshuar, nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (NJMBNJ), akti i deklaramit të statusit të punësimit, sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, kryhen procedurat e transferimit, të parashikuara në dispozitat e tij.

c) Për punonjësit që mbulojnë pozicione të shërbimit civil, por NJMBNJ-ja nuk është shprehur në lidhje me statusin e tyre të punësimit, sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, NJMBNJ-ja e bashkisë, merr funksionet e organit përgjegjës dhe shprehet në lidhje me statusin e tyre të punësimit.

ç) Brenda pesë muajve nga data e konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, bashkia duhet të ketë kryer procedurat, sipas pikës 1. Për të mundësuar transferimin dhe pozicionimin në kohë të personelit, sipas pikës 1, dosjet e personelit të NJSH-së duhet të depozitohen pranë bashkisë jo më vonë se një muaj nga momenti i konstituimit të organeve të saj. Ngarkohen personat përgjegjës për çështjet e personelit në NJSH për plotësimin e këtij detyrimi brenda afatit të përcaktuar.

KREU V

TRANSFERIMI I ARKIVAVE DHE I DOKUMENTACIONIT

1. Bashkia është trashëgimtarja e ligjshme e NJSH-ve dhe është përgjegjësjë e ardhshme për arkivat e këtyre njësive, për të vendosur për administrimin e mëtejshëm të dokumenteve. Përpara se të vendosë për transferimin e dokumentacionit të njësive të shkrië, bashkia duhet të sigurojë ambiente të përshtatshme. Arkivat e NJSH-ve nuk mund të bashkohen dhe përzihen me atë të bashkisë, pasi duhet të rrinë, qartësisht, të identifikueshme, si elemente arkivore të ndara.

2. NJSH-të, përpara datës së dorëzimit të dokumentacionit pranë bashkisë, duhet të kenë përfunduar përpunimin për dokumentacionin e viteve të mëparshme, përfshirë atë të vitit 2014. Përpunimi apo klasifikimi sipas fondeve duhet të kryhet në përputhje me normat teknike-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të miratuara me vendimin nr. 1, datë 16.1.2004, të Këshillit të Lartë të Arkivave, në mbështetje të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat". Në kryerjen e këtij procesi, NJSH-të do të mbikëqyren nga arkivi shtetëror vendor përkatës.

3. Dokumentet arkivore, të sistemuara dhe inventarizuara sipas pikës 2, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ pranë NJSH-së, do të dorëzohen për ruajtje dhe administrim pranë arkivave shtetërore vendore, sipas juridiksionit territorial përkatës. Në rast rreziku të dukshëm, dëmtimi a zhdukjeje fizike, arkivat shtetërore vendore mund të tërheqin për ruajtje dhe administrim edhe dokumente arkivore për të cilat nuk ka përfunduar afati ligjor i shërbimit operativ pranë NJSH-së. Dokumentet në ruajtje të përkohshme, për të cilat nuk ka përfunduar afati i ruajtjes, duhet të vazhdojnë të ruhen pranë NJSH-së deri në transferimin pranë bashkisë, pasi të jenë krijuar hapësirat e nevojshme. Për këtë, arkivat e NJSH-ve mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas konstituimit të bashkisë, por, gjithsesi, për jo më shumë se 6 muaj nga ky moment.

4. Të gjitha dokumentet që janë prodhuar përpara datës 1 janar 2015, por që përmbajnë procedura që janë në vazhdim, si dhe ato të vitit 2015, dorëzohen me procesverbal, sipas regjistrimit të korrespondencës, në bashki, për të siguruar vazhdimësinë e ndjekjes së veprimeve dhe procedurave të filluara pranë NJSH-së. Marrja me procesverbal bëhet jo më vonë se 2 muaj nga momenti i konstituimit të organeve të bashkisë, nëse kjo nuk sjell pasoja të rënda dhe të parikuperueshme në veprimtarinë dhe funksionet e kësaj të fundit.

5. Dorëzimi i dokumentacionit dhe i arkivit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat. Dorëzimi formal bëhet nëpërmjet një formati tip, që vendoset në dispozicion nga Arkivi i Shtetit.

6. Me transferimin pranë bashkisë, një kopje e arkivit ruhet edhe pranë NJSH-së, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në format shkresor ose të digjitalizuar.

KREU VI

TRANSFERIMI I PASURIVE DHE REGJISTRIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME

1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme, të NJSH-ve. Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe të ekzekutive, ajo ushtron të drejtën e pronësisë, si dhe të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme, inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen.

3. Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, brenda datës 31.12.2015, duhet të dërgojë informacion të plotë, pranë çdo bashkie, në lidhje me pronat që janë transferuar ndër vite te NJSH-të.

4. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, sipas ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Në përfundim të regjistrimit të pronave, në emër të bashkisë, ZRPP-ja dërgon dokumentacionin e përditësuar pranë çdo bashkie, por jo më vonë se 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

KREU VII

KONSOLIDIMI FINANCIAR

1. NJSH-të, brenda 2 muajve nga konstituimi i organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë, duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare që përfshijnë tërësinë e aktivitetit të tyre deri në datën e fundit të funksionimit.

2. Bashkia integron pasqyrat financiare të NJSH-ve me pasqyrat e veta dhe, në përfundim të vitit ushtrimor, përgatit bilancin e konsoliduar, duke përfunduar kështu, bashkimin financiar të bashkisë.

3. Konsolidimi financiar bëhet sipas një metodologjie të unifikuar, me udhëzim të ministrit të Financave dhe ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore.

KREU VIII

ÇËSHTJE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

1. Bashkia duhet të sigurojë infrastrukturën bazë të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit elektronik për të garantuar shpërndarjen efiçente dhe të sigurt të informacionit.

2. Për të garantuar ruajtjen e dokumenteve elektronike si edhe të bazës së të dhënave në formë digjitale, gjatë periudhës së transferimit, bashkia duhet të sigurojë infrastrukturën bazë për ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave në rast humbjeje.

3. Për të siguruar integritetin e informacionit dhe tërësinë e të dhënave apo dokumenteve që do të transferohen, bashkia duhet të zbatojë procedura për garantimin e sigurisë së informacionit gjatë procesit të transferimit.

KREU IX

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Detajimi i procedurave të plotësimit të dokumentacionit, të kërkuara nga ky vendim, bëhet me udhëzim të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore.

2. Ngarkohen bashkitë, NJSH-të, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Copyright 2015 - www.ligjet.org



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A "UJËSJELLËS – KANALIZIME" – PATOS
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Patos më, 27/06/2019

Nr. 92/1 Pro1

V E N D I M

Nr. 1 dt. 27/06 /2019

Për miratimin e largimit të Bashkisë Fier si Aksioner të Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" sh.a Patos

Në mbështetje të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 63 datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime" sh.a - Patos nr.1 dt.22.04.2016 "Për miratimin e statutit të shoqërisë aksionere "Ujësjetllës Kanalizime" sh.a Patos", pasi shqyrtova projekt – vendimin e propozuar nga Administratori i Shoqërisë:

VENDOSA

1. Të miratoj largimin e Bashkisë Fier si aksioner i Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" Patos.
2. Një kopje e këtij vendimi të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznësit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" Patos.
4. Ku vendim u shpall sot më dt. 27/06 /2019.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

KRYETARE

Rajmonda BALHAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A "UJËSJELLËS – KANALIZIME" – PATOS
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Patos më, 27/06/2019

Na. 3212 Pres

V E N D I M

Nr. 2 dt. 27 / 06 /2019

*Për miratimin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" sh.a
Patos si pasojë e tërheqjes si aksioner të Bashkisë Fier*

Në mbështetje të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, nenin 7 gërna "d" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63 datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime" sh.a - Patos nr.1 dt.22.04.2016 "Për miratimin e statutit të shoqërisë aksionere "Ujësjetllës Kanalizime" sh.a Patos", pasi shqyrtova projekt – vendimin e propozuar nga Administratori i Shoqërisë:

VENDOSA

1. Të miratoj zvogëlimin me 1 140 (njëmijë e njëqind e dyzetë) aksione me vlerë 1 000 lek/aksion.
2. Kapitali i Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" sh.a Patos me ndryshimet e mësipërme shkon nga 2 500 000 (dymilion e pesëqindëmijë) lek në 1 360 000 (njëmilion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lek
3. Një kopje e këtij vendimi të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznësit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" Patos.
5. Ku vendim u shpall sot më dt. 27 / 06 /2019.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

KRYETARE

Rajmonda **BALILAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A "UJËSJELLËS – KANALIZIME" – PATOS
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 9213 Pat

Patos më 27/06/2019

V E N D I M

Nr. 3 dt. 27/06/2019

Për miratimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" sh.a Patos

Në mbështetje të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, nenin 7 gërna "d" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63 datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime" sh.a - Patos nr.1 dt.22.04.2016 "Për miratimin e statutit të shoqërisë aksionere "Ujësjetllës Kanalizime" sh.a Patos", pasi shqyrtova projekt – vendimin e propozuar nga Administratori i Shoqërisë:

VENDOSA

1. Të miratoj shtesën me 13 170 (trembëdhjetëmijë e njëqind e shtatëdhjetë) aksione me vlerë 1 000 lek/aksion.
2. Kapitali i Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" sh.a Patos me ndryshimet e mësipërme shkon nga 1 360 000 (njëmilion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lek në 14 530 000 (katërmëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë mijë) lek
3. Një kopje e këtij vendimi të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznësit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Shoqërisë "Ujësjetllës – Kanalizime" Patos.
5. Ku vendim u shpall sot më dt. 27/06/2019.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

KRYETARE

Rajmonda BALILAJ





**BASHKIA FIER
KESHILLI I BASHKISE**

Adresa: Lagjia "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi", Nr. 15 Fier - SHQIPËRI Tel. 034 410 636; bashkia fier.gov.al

11.4128/2

VENDIM
Nr. 60 date 21.06.2016.

21.06.2016

"Për ndarjen e Bashkise Fier nga Ujesjelles Kanalizime sh.a. Patos dhe Ujesjelles Kanalizime Lushnje Fshat sh.a


Në mbështetje të, Ligjit 139 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore; Ligjit 115 date 18.12.2014 "Per Ndarjen Administrativo Territoriale te Njesive te Qeverisjes vendore ne republiken e Shqiperise"; Ligjit 9901 "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"; VKM Nr 63 date 27.01.2016 "Per riorganizimin e Operatoreve qe Ofrojne Sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura"; VKM Nr 510 date 10.06.2015, "Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupezuara e te parrupezuara, te arkivave dhe cdo dokumentacioni tjetër zyrtar ne njesite e qeverisjes vendore, te prekura nga riorganizimi territorial", Këshilli i Bashkisë Fier në mbledhjen e tij të datës 7.1/6/2016, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI :

1. Te miratoje ndarjen e Bashkise Roskovec nga Ujesjelles Kanalizime Fier sh.a, mbeshtetur edhe ne vendimin Nr 39 date 09.12.2015 te Keshillit te Bashkise Roskovec, konfirmuar me shkresen e Prefektures Fier Nr 1481/1 prot date 15.12.2015. Te miratoje ndarjen e Bashkise Roskovec nga Ujesjelles Kanalizime Fier sh.a, mbeshtetur edhe ne vendimin Nr 39 date 09.12.2015 te Keshillit te Bashkise Roskovec, konfirmuar me shkresen e Prefektures Fier Nr 1481/1 prot date 15.12.2015.
2. Te miratoje ndarjen e Bashkise Fier nga Ujesjelles sh.a. Patos.
3. Te miratoje ndarjen e Bashkise Fier nga Ujesjelles Lushnje Fshat sh.a
4. Me ndryshimet e mesiperme Ujesjelles Kanalizime sh.a. Fier do te jete nje Shoqeri qe do te mbuloje te gjithe territorin e Bashkise Fier.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme Ekonomike e Bashkisë dhe Drejtoria e Pergjithshme e Legjislacionit.

Ky vendim u shpall me datë 21.06.2016
Ky vendim hyn në fuqi, sipas Ligjit

KRYETARI I KESHILLIT TE BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM
Nr.57.dt.20.09.2018

**PËR MIRATIMIN E NDARJES SË BASHKISË FIER NGA UJËSJELLËS
KANALIZIME sh.a - PATOS**

Bazuar në shkronjën “d” dhe “gj” neni 54 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen Administrativo – Teritoriale të Njësive të Vetqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.9901 “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.63 dt.27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.510 dt.10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e tëpatrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi territorial”, Këshilli I Bashkisë I mbledhur në dt.20.09.2018 pasi analizoi projektvendimin e paraqitur nga ekzekutivi,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndarjen e Bashkisë Fier nga Shoqëria “Ujësjellës – Kanalizime Patos” sh.a, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Fier nr.60 dt.21.06.2016 “Për ndarjen e Bashkisë Fier nga Ujësjellës Kanalizime sh.a Patos.
2. Me ndryshimet e mësipërme Shoqëria “Ujësjellës – Kanalizime Patos” sh.a do të jetë një Shoqëri që do të mbulojë të gjithë territorin e Bashkisë Patos.

Ky vendim u shpall në dt. 25/09/2018

**Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë për zbatimin e këtij Vendimi.
Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.**

SEKRETARI

Balil BALILI



KRYETARI

Artan VELÇANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM
Nr.58.dt.20.09.2018

PËR EMËRIMIN E EKSPERTIT KONTABEL TË AUTORIZAR PËR TË KRYER
VEPRIMET E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT TË UJËSJELLËS KANALIZIME
sh.a.PATOS.

Bazuar në shkronjën “gj”, “k” neni 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”. Ligji 115/2014 Për ndarjen Administrative Teritoriale të njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”. Ligji nr.9901 “Për tregëtarë dhe shoqëri tregëtare”, V.K.M NR.63 DT.2701.2016 “Për organizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit të ujit të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”. Këshilli i Bashkisë i mbledhur në dt.20.09.2018, mbasi analizoi kërkesën e ekzekutivit për caktimin e ekspertëve kontabël që do të shërbejnë në ndarjen e Ujësjiellës kanalizimeve sh.a Patos nga Bashkia Fier,

VENDOSI:

1-Të emërojë ekspert kontabel të autorizuar znj.Aida Maloku dhe znj .Valentina Haxhi.

2-Ekspertet do të përpilojnë raportin e ndryshimit të kapitalit të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Patos”, mbështetur në ndryshimet e ndodhura sipasojë e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.63 dt.27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”.

3-Ujësjiellës Kanalizime sh.a Patos të depozitojë pranë QKB vendimin e emërimit të ekspertit kontabel.

Ky vendim u shpall në dt. 25 /09/2018

Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Balil BALILI

KRYETARI

Artan VELÇANI



Verifikuar nga me
P. Jakti
SEKRETARI
BASHKIA PATOS